



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:134605

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05671506

C.nr.694/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me bashkëpunorën profesionale Mirvedete Bekteshi, në çështjen juridike civile sipas padisë së paditësve Z.K dhe H.K, të punësuar në SHFMU“Naum Veqilharxhi” në M, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Q.H nga S, ndaj të paditurës K së S, D së A, përfaqësuar nga A.B me akt emërim, për shkak të kompensimit në emër të kualifikimit – licencimit, pagës jubilarë, shpenzimeve të udhëtimit, shujtave ditore dhe inflacionit, vlera e kontestit e pa përcaktuar, me dt.10.05.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M **Pa shqyrtim kryesor**

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësve Z.K dhe H.K, të punësuar në SHFMU“Naum Veqilharxhi” në M K. S.

II. DETYROHET e paditura K e S – D. K e A që paditësve:

1)**Z. K** - në emër të kompensimit të kualifikimit - licencimit prej 27% të pagës bazë $421 \times 27\% = 113.67 - 58.32$ diferenca prej 55.32 euro për 43 muaj, nga data **30.06.2019** deri me **06.02.2023** t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej **2.380,05 euro (Dymijë e treqind e tetëdhjetë euro e zero pesë cent)**;

-në emër të kompensimit të pagës jubilarë për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë 492.73 €, ti paguaj shumën prej **369.54 euro (Treqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë e katër cent)**;

-në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 09.03.2022 deri me 21.11.2022 për 86 x 2.1 euro, në shumën totale prej **180.60 Euro(Njëqind e tetëdhjetë euro e gjashtëdhjetë cent)** ;

-në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 14.09.2020 deri me 21.11.2022 për 394 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **788 E(Shtatëqind e tetëdhjetë e tetë euro)**;

-në emër të kompensimit të diferencës së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit për periudhën 30.06.2019 deri me datë 31.11.2022, të paguajë shumën dhe atë:

-Për periudhën Korrik – Dhjetor 2019, paga $421 \times 6 = 2526 \times 2.7\% =$ shumën prej **60.20 euro**;

-Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, paga $421 \times 12 = 5.052 \times 0.2\% =$ shumën prej **10.10 euro**;

Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, paga $421 \times 12 = 5052 \times 3.4\%$, shumën prej **171.76 euro**;

Për periudhën prej Janar – Nëntor 2022, paga $421 \times 11 = 4.631 \times 11.6\%$, shumën prej **537.19 euro**, në shumën totale prej **4.503.05 €(katërmijë e pesëqind e tre euro e zero pesë cent)** si dhe kamatëvonesën në vlerën prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë 30.06.2022 e deri në pagesën definitive, dhe

2) H. K - në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 09.03.2022 deri me 21.11.2022 për 86 ditë pune, x 2.1 euro, në shumën totale prej **180.60 Euro(Njëqind e tetëdhjetë euro e gjashtëdhjetë cent)** ;

-në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 14.09.2020 deri me 21.11.2022 për 296 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **592 €(Pesqind e nëntëdhjetë e dy euro)**;

-në emër të kompensimit të diferencës së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit për periudhën 30.06.2019 deri me datë 31.11.2022, të paguajë shumën dhe atë:

-Për periudhën Korrik – Dhjetor 2019, paga $241.68 \times 6 = 1.450.08 \times 2.7\% =$ shumën prej **39.15 euro**;

-Për periudhën Janar – Dhjetor 2020, paga $241.68 \times 12 = 2.900 \times 0.2\% =$ shumën **prej 5.80 euro;**

Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, paga $241.68 \times 12 = 2.900.48 \times 3.4\%$, shumën **prej 98.60 euro;**

Për periudhën prej Janar – Nëntor 2022, paga $241.68 \times 11 = 2.658.48 \times 11.6\%$, shumën **prej 308.38 euro, në shumën totale prej 1.224.53 E(njëmijë e dyqind e njëzetë e katër euro e pesëdhjetë e tre cent)** si dhe kamatëvonesën në vlerën prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë 30.06.2022 e deri në pagesën definitive.

III. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë deri me datë 30.06.2019, si e parashkruar,

IV. OBLIGOHET e paditura që paditësve t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë; për përpilimin e padisë 104 euro, për precizimin e padisë 156 Euro, në total shumën 260 euro sipas TOAK-së, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Z.K dhe H.K, mësimdhënës në SHFMU“Naum Veqilharxhi” në M, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Q.H nga S, ndaj të paditurës K së S, kan parashtruar padi me datën 30.06.2022 kundër të paditurës K e S – D. K e A, për pagesën e kompensimit kualifikimit – licencimit, pagës jubilarë, shujtës, udhëtimit dhe inflacionit, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. I autorizuari i paditësve me anë të parashtrës së datës 08.12.2023 ka bërë precizimin dhe zgjerimin e padisë në aspektin objektiv – për shutja ditore dhe në aspektin subjektiv si paditës do të jetë edhe H. K, për kompenzimin e licencimit, pagës jubilarë, shujtës, udhëtimit dhe inflacionit.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt. 06.11.2023 ka precizuar se për të mos u kriju shpenzime të procedurës së panevojshme i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë të cilën paditësit e vërtetojnë me prova materiale relevante për ditët e vijueshmërisë në shkollë ta aprovojë.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se: Kërkesëpadia e paditësve është **e bazuar**.

Në nenin 7 par. 1 i Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”

Gjykata pas analizimit të provave të prezentuara nga paditësit siq janë kontrata e punës e lidhur mes ndërgjyqësve, - licencës, vërtetimeve nga mardhënia e punës, vërtetimi nga kompania e udhëtimit, tabelën e inflacionit, dhe provave të tjera ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet në tërësi dhe e paditura ka për obligim t’ia paguaj kompensimin e kualifikimit – licencimit, kompenzimin e shujtave ditore, pagën jubilarë për 20 vite pune, shpenzimet e udhëtimit dhe kompenzimin e iflacionit.

I autorizuari i paditësit, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e kualifikimit – licencimit, kompenzimit jubilar, kompenzimin e shujtave ditore, kompenzimin e udhëtimit dhe inflacionin, i ka bashkëngjitur padisë Listën e pagës, për paditësin e parë kontratën e punës nr.114, Licencën e mesimdhënësit nr. 100012579, Diplomën me nr. 6, vërtetimin nga marëdhënia e punës nr.210/23, vëtetimi nga kompania NTT S, tabelën e inflacionit dhe autorizimin, për paditësin e dytë listën e pagës, kontratën e punës nr.109, vërtetimin nga marëdhënia e punës 83/22, vëtetimin nga kompania NTT S, tabelën e inflacionit dhe autorizimin.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditëseve gjen mbështetje të plotë në Kontratën Kolektive e 18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, në nenin 7 par.1.3 të drejtën në licencim, në nenin 35 par. 5 të drejtën e shpenzimeve të udhëtimit, par. 7 për shpenzimet e ushqimit, në par. 8 në pagën jubilarë dhe në par. 10 të drejtën për shkallën e inflacionit e llogaritur në tabelën e inflacionit të

lëshuar nga parashtresa e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Gjykata ka vërtetuar se e paditura është e obliguar ndaj paditëseve konform nenit 7 dhe 35 par. 5, par. 7. par 8. dhe 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, që t'ia paguaj kompensimin licencimin në vlerën 27%, të pagës bazë, kompenzimin jubilar në vlerë prej 75% të pagës bazë, shujtat ditore dy euro në ditë, shpenzimet e udhëtimit 70% të biletës dhe kompenzimin e inflacionit në tabelën e inflacionit numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023, andaj vendosi që paditësve t'i kompensohet shuma e papaguar e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi që t'ia falte besimin provave që kan prezantuar paditësit, konkretisht Listën e pagës, për paditësin e parë kontratën e punës nr.114, Licencën e mesimdhënësit nr. 100012579, Diplomën me nr. 6, vërtetimet nga marëdhënia e punës nr.210/23, vëtetimi nga kompania NTT Sedolli, tabelën e inflacionit dhe autorizimin, për paditësin e dytë listën e pagës, kontratën e punës nr.109, vërtetimin nga marëdhënia e punës 83/22, vëtetimin nga kompania NTT Sedolli, tabelën e inflacionit dhe autorizimin, me të cilat u vërtetua se paditësit janë të punësuar në SHFMU“Naum Veqilharxhi” në Mohlan, K. Suharekë, dhe se për 86 ditë kan udhëtuar nga K në fshatin G, dhe në bazë të të gjitha provave të cekuta më lartë e të analizuara nga gjykata u vendos që e padituria tua kompenzon të gjitha shpenzimet për licencim, ushqim, udhëtim, jubilarë dhe inflacion siq është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve është mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/33 të datës 29.08.2008 nenit 7 dhe neni 35 par. 5, parag 7 , paragrafi 8 dhe 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, e cila është akt më i lartë se kontrata e punës në mes paditësve dhe të paditurës, kjo bazuar sipas nenit 4 të Ligjit të Punës, theksohet se hierarkia tek marrëdhënia e punës së pari vlen Ligji i Punës, pastaj Kontrata Kolektive e më pas kontrata në mes të punësuarit dhe punëdhënësit si dhe në tabelën e inflacionit të lëshuar nga parashtresa e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Gjykata si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, refuzoi pjesën e kërkespadi së deri me datë 30.06.2019, për shkak të parshkrimit pasi që sipas Ligjit të Punës, nenit 87 theksohet se, citojmë: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale për padi dhe precizim të padisë, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së

Gjykata Aktgjykimin e muarr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.694/2022, datë 10.05.2024

Gj y q t a r i
Robert Tunaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej **7 ditëve** nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjyka